

Njoftimi i privatësisë - Shërbimet e Bluelink-ut

Në fuqi nga data 1 janar 2025.

Other language versions of this Privacy Notice can be accessed and downloaded from: [<https://www.hyundai.com/eu/bluelink-privacy-notice>]

Lista e ndryshimeve

- [4.1.1](#) Ne do të përpunojmë numrin tuaj të identifikimit të automjetit (VIN), kategoritë e Shërbimeve që keni aktivizuar dhe datën fillestare të aktivizimit.
- [4.1.2](#) Ne kemi përditësuar qëllimet e përpunimit të të dhënave.
- [4.3.2](#) Janë shtuar cilësimet e privatësisë.
- [4.3.3](#) Nëse mbërrini dhe parkoni në pika të caktuara POI, ne do t'i transferojmë të dhënat e mëposhtme në lidhje me këtë ngjarje tek ofruesi ynë i shërbimit, në mënyrë që ai të masë efektivitetin e përmbajtjes së palëve të treta dhe të përmirësojë shërbimet e ofruara: Pozicioni GPS i parkimit me gjerësi/gjatësi të paqartë gjeografike përtej 4 shifrave pas presjes dhjetore (pa të dhëna të sakta për vendndodhjen) dhe dita e ngjarjes së parkimit (pa vulë të saktë kohore) së bashku me ID-në e pajisjes dhe ID-në e ofertës.
- [4.3.6.1](#) Është shtuar itinerari i preferuar.
- [4.4.2](#) Është shtuar veçoria e monitorit të pamjes rrethuese.
- [4.7](#) Është shtuar përpunimi i të dhënave për qëllime të lidhura me sigurinë kibernetike. Në vend të këtij kapitulli të ri, është fshirë shtojca e mëparshme (Përpunimi i të dhënave në kontroll të përbashkët me Hyundai Motor Company).
- [8.3](#) Është fshirë veçoria e listës së shërbimeve.

1. Për çfarë është ky Njoftim privatësie?

Qëllimi i këtij njoftimi privatësie ("Njoftimi i privatësisë") është t'ju informojë rreth grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave tuaja personale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të Hyundai Bluelink Europe ("Bluelink" ose "Shërbimet") për ju përmes sistemit të info-argëtimit të makinës (kjo është njësisia e kroskotit të automjetit) dhe aplikacionit Hyundai Bluelink Europe ("Aplikacioni").

Ne e marrim shumë seriozisht privatësinë dhe i përpunojmë të dhënat personale vetëm në përputhje me ligjet në fuqi të mbrojtjes së të dhënave.

Çdo përpunim i të dhënave personale që lidhen me regjistrimin e llogarisë në fjalë (duke përfshirë të dhënat tuaja personale, si për shembull emri, adresa e emailit, datëlindja ose numri i telefonit celular) është subjekt i një njoftimi të veçantë të privatësisë.

2. Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave të mia?

Hyundai Connected Mobility GmbH, me seli në adresën Kaiserleipromenade 5, 63067 Offenbach, Gjermani ("Hyundai"), është ofruesi i Shërbimeve dhe do të

jetë përgjegjës për përpunimin e të dhënave tuaja personale, siç shpjegohet në këtë Njoftim të privatësisë.

Hyundai do të referohet si "ne", "tona" ose "neve".

Ne mund t'i përdorim të dhënat tuaja personale për qëllime të tjera, siç përshkruhet më poshtë.

Për sa i përket Shërbimeve të veçanta që renditen në seksionin [6](#), ne do të veprojmë si bashkë-kontrollorë në bashkëpunim me kompanitë e grupit Hyundai dhe/ose me distributorin e autorizuar në vendin ku keni kryer blerjen.

Emrat dhe të dhënat e plota përkatëse të kontaktit të bashkë-kontrollorëve mund të gjenden në seksionin [13](#).

Ne dhe bashkë-kontrollori lidhim një marrëveshje që trajton përpunimin e të dhënave personale.

Ne do t'ju ofrojmë informacion rreth përbërjes së kësaj marrëveshjeje, në vijim të kërkesës suaj.

3. Si mund ta kontaktoj kontrolluesin dhe oficerin e mbrojtjes së të dhënave?

3.1. Nëse keni pyetje për këtë Njoftim të privatësisë apo në lidhje me të ose rreth ushtrimit të ndonjë prej të drejtave tuaja, mund të kontaktoni qendrën telefonike për klientët e Hyundai në numrin e telefonit +49 69271472377.

Gjithashtu mund të kontaktoni me Hyundai-n duke dërguar një email në adresën bluelink@hyundai-europe.com.

3.2. Përndryshe mund të kontaktoni me oficerin tonë të mbrojtjes së të dhënave në adresën e emailit HCM.dataprotection@hyundai-europe.com ose duke i shkruar në adresën:

c/o Data Protection Officer
Kaiserleipromenade 5
63067 Offenbach, Gjermani
Hyundai Connected Mobility GmbH

4. Çfarë kategorish të dhënash personale përpunohen, për çfarë qëllimesh dhe mbi çfarë baze ligjore?

4.1. Përpunimi i të dhënave tuaja personale nga ne

4.1.1. Ofrimi i shërbimeve të Bluelink-ut

Ne i grumbullojmë dhe i përpunojmë të dhënat tuaja personale lidhur me Shërbimet vetëm për atë që grumbullojmë dhe përpunimi është:

- i nevojshëm për realizimin ose përmbushjen e kontratës së Bluelink-ut (Neni 6 (1) b) i GDPR-së),
- kërkohet nga ligji (Neni 6 (1) c) i GDPR-së),
- bazohet te pëlqimi (Neni 6 (1) a) i GDPR-së) ose
- është i nevojshëm për qëllimet e interesave legjitime tonat ose të palëve të treta (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

Për detaje rreth Shërbimeve individuale, ju lutemi referojuni përshkrimit të shërbimit përkatës të "Kushtet e përdorimit të Bluelink-ut".

Të gjitha të dhënat (personale) të përshkruara në paragrafët [4.2](#), [4.3](#), [4.4](#), [4.5](#) dhe nënparagrafët përkatës më poshtë, grumbullohen direkt nga automjeti juaj (p.sh. sensorët e tij dhe aplikacionet përkatëse që bëhen të aksesueshme përmes

sistemit të info-argëtimit) ose ju janë vënë në dispozicion përmes Aplikacionit (p.sh. duke futur të dhëna të caktuara personale përmes Aplikacionit) dhe përpunohen në lidhje me Shërbimet.

Të dhënat e përshkruara në paragrafët [4.2](#), [4.3](#), [4.4](#) dhe [4.5](#) dhe nënparagrafët përkatës më poshtë janë të detyrueshme për të ofruar Shërbimet. Pa këto informacione, nuk mund të përmbushen Shërbimet.

Për më tepër, ne do të përpunojmë gjithashtu edhe numrin tuaj të identifikimit të automjetit (VIN), kategoritë e Shërbimeve që keni aktivizuar dhe datën fillestare të aktivizimit. Baza ligjore është Neni 6 (1) b) i GDPR-së (lidhja e një kontrate dhe kryerja e Shërbimeve tona).

4.1.2. Përpunimi për qëllime të tjera

Përveçse për ofrimin e Shërbimeve, ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale edhe për qëllime të tjera, siç përshkruhet më poshtë.

- **Përmirësimi / zhvillimi i produkteve:** Nëse ju jeni dakord, ne do t'i analizojmë dhe përmirësojmë më tej Shërbimet për të zhvilluar produkte dhe/ose shërbime të reja që lidhen me lëvizshmërinë, për t'i bërë produktet tona më të sigurt dhe/ose për t'i përmirësuar Shërbimet tona.
- Për këto qëllime, bazuar në modelet statistikore dhe matematikore, ne i analizojmë automatikisht të dhënat e grumbulluara kur ofrojmë Shërbimet, për të identifikuar potencialin për përmirësime nëse i keni aktivizuar të gjitha Shërbimet ose keni zgjedhur kategorinë e shërbimit "Përmirësimi i produktit/shërbimit" në cilësimet e privatësisë së sistemit tuaj të info-argëtimit. Më shumë detaje jepen në paragrafin [4.5](#).
- Baza ligjore për këtë përpunim është Neni 6 (1) f) i GDPR-së (interesat legjitime të Hyundai-t dhe të Distributorit për t'i përpunuar të dhënat tuaja personale me qëllimin për t'i zhvilluar dhe përmirësuar Shërbimet tona).
- **Monitorimi i produkteve / përgjegjësia për produktet:** Në këtë kontekst, ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për të monitoruar produktet tona, për garantuar standarde të mjaftueshme të sigurisë së TI-së ose për të mbrojtur veten a palët e treta nga përgjegjësia për produktet dhe nga pretendime të tjera ligjore të bëra në lidhje me produktet dhe Shërbimet tona.
- Përderisa një përpunim i tillë nuk kërkohet nga ligji (Neni 6 (1) c) i GDPR-së), baza ligjore për çdo përpunim të tillë është Neni 6 (1) f) i GDPR-së (interesat legjitime të Hyundai-t dhe të Distributorit për t'i përpunuar të dhënat tuaja personale për qëllimet e treguara më sipër).
- Përmbushja e detyrimeve ligjore: Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për të përmbushur detyrime të ndryshme ligjore (Neni 6 (1) c) i GDPR-së), në veçanti ligjet e zbatueshme për prodhuesit e makinave. Shembuj të detyrimeve të tilla përfshijnë:
 - ▶ ofrimin e funksioneve të caktuara në makinë si "eCall" në përputhje me rregulloren (BE) 2015/758,
 - ▶ raportimin e informacioneve të caktuara (pra, që lidhen me funksionimin e asistencës inteligjente të shpejtësisë - ISA, Sistemet e Ndihmës për

Kontrollin e Drejtuesit - DCAS etj.) tek autoritetet përkatëse kombëtare dhe/ose evropiane, në bazë të rregullores (BE) 2019/2144;

- ▶ dhënien e informacionit gjykatave ose autoriteteve të ndjekjes penale bazuar në ligjet penale ose administrative në fuqi.
- **Qëllime të tjera:** Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për qëllime të tjera vetëm nëse jemi të detyruar ta bëjmë këtë në bazë të kërkesave ligjore (Neni 6 (1) c) i GDPR-së), nëse keni dhënë pëlqimin për përpunimin përkatës (Neni 6 (1) a) i GDPR-së) ose nëse përpunimi është përndryshe i ligjshëm sipas ligjit në fuqi.
- Nëse ndodh përpunim për një qëllim tjetër, Hyundai dhe/ose Distributori do t'ju japin informacion shtesë aty ku është e përshtatshme.

4.1.3. Mospërfshirja në vendimmarrje të automatizuar

As Hyundai, as Distributori, nuk përfshihen në vendimmarrje të automatizuar, përfshirë profilizimin në lidhje me Shërbimet, përveçse kur kjo njoftohet shprehimisht ndryshe me mjete të tjera.

4.2. Llogaria Hyundai

Llogaria Hyundai kërkohet për t'u regjistruar për shërbime të shumta (të ofruara nga ne ose nga palë të treta bashkëpunuese).

Përpunimi themelor i të dhënave tuaja personale është i nevojshëm për të lidhur dhe për të përmbushur një kontratë me ju (Neni 6 (1) b) i GDPR-së) dhe bazohet në interesin tonë legjitim për ta përmirësuar përvojën tuaj të klientit duke ju ofruar një llogari përdoruesi të centralizuar (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

Llogaria Hyundai është një llogari përdoruesi qendrore në të cilën mund të menaxhoni të dhënat tuaja kryesore personale dhe të cilën mund ta përdorni si identifikim unik për shërbimet tuaja të lidhura.

Për të përdorur shërbimet e Bluelink-ut është e nevojshme të krijoni një llogari Hyundai ose të identifikoheni me një llogari ekzistuese Hyundai.

Në këtë rast, shërbimet e Bluelink-ut do të lidhen me llogarinë tuaj Hyundai dhe do të shfaqen të dhënat tuaja kryesore personale (adresa e emailit, titulli juaj, emri dhe mbiemri, shteti dhe gjuha e preferuar).

Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni Njoftimit të veçantë të privatësisë për llogarinë Hyundai, të cilin mund ta gjeni këtu: https://eu-account.hyundai.com/auth/resources/o5704/login/hyundai-id/legal_en.html

4.3. Ofrimi i shërbimeve të Bluelink-ut - sistemi i info-argëtimit i automjetit

4.3.1. Cilësimet e privatësisë

Në cilësimet e privatësisë të sistemit tuaj të info-argëtimit, ju keni mundësinë të aktivizoni të gjitha Shërbimet në automjet, të zgjidhni vetëm disa kategori të Shërbimeve ose të aktivizoni modalitetin jashtë linje në çdo kohë. Ne do të përpunojmë vetëm të dhënat që janë të nevojshme për t'ju ofruar Shërbimet që keni zgjedhur sipas informacionit të dhënë më poshtë.

4.3.2. Hyundai Live

Hyundai Live ju mundëson të përdorni funksionet e mëposhtme:

- Trafiku drejtpërdrejt: Informacion i drejtpërdrejtë mbi trafikun për llogaritjen e itinerareve, duke përfshirë kohën e saktë të mbërritjes dhe shfaqjen e situatës së trafikut bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale

- Parkimet drejtpërdrejt: Parkimet në rrugë dhe jashtë rrugës, afër pozicionit aktual, afër destinacionit, afër shenjës së lëvizjes në ekran
- Pikat e karburantit drejtpërdrejt: Informacion në lidhje me pikat më të afërta të karburantit dhe çmimet e karburantit bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale
- POI-të (Pikat e interesit) për EV-të drejtpërdrejt (*vetëm për automjetet elektrike dhe automjetet elektrike hibride plug-in*): Informacion mbi stacionet e karikimit në afërsi, duke përfshirë statusin e disponueshmërisë dhe llojin e karikuesit bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale
- Moti: Informacioni lokal i motit bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale
- Servisi i Hyundai-t: Informacion mbi distributorët e Hyundai-t ose mbi vendndodhjet e servisit në afërsi, bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale
- POI-të drejtpërdrejt dhe kërkim me tekst të lirë drejtpërdrejt: Informacion mbi POI-të në afërsi bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale, duke përfshirë pineskat e markave dhe kërkimet e promovuara me ofertat në makinë, duke ju lejuar të përfitoni nga promovimet e shitësve të palëve të treta në kategori të ndryshme POI
- Sinjalizimet për kamerat / zonat e rrezikut (*nëse lejohet ligjërisht në vendin tuaj*): Sistemi ofron sinjalizime në zonat ku aksidentet janë veçanërisht të zakonshme dhe ju paralajmëron për pikat e nxehta të aksidenteve ose kamerat e shpejtësisë
- Liga sportive: Informacion mbi rezultatet e eventeve të fundit sportive

Për të ofruar Shërbimet tona Hyundai Live kërkohet mbledhja dhe përpunimi i numrit të identifikimit të automjetit tuaj (VIN), i të dhënave të vendndodhjes (p.sh. koordinatat GPS për informacionin e trafikut drejtpërdrejt), i identifikuesit të kartës së qarkut të integruar të kartës SIM të automjetit tuaj (ICCID) dhe një ID kërkesë unike për çdo transaksion.

Në lidhje me POI-të drejtpërdrejt që përmbajnë përmbajtje reklamimi nga palë të treta, mund të jetë e nevojshme të transferoni të dhënat e mëposhtme te ofruesi ynë i shërbimit (4.screen GmbH, Sailerstraße 17, 80809 Munich, Gjermani) në mënyrë që t'ju ofrojë informacionin përkatës siç kërkohet : zona e përafërt e kërkimit, termi i kërkimit, kategoria e kërkimit (POI), ID-ja e pajisjes, vendndodhja e përafërt e pajisjes, gjuha dhe gjenerimi i njësisë kryesore, marka e makinës, lloji i motorit (p.sh. makinë elektrike ose me benzinë), klasa e automjetit (p.sh. veturë, SUV), viti i prodhimit të automjetit dhe vendi i automjetit.

Për më tepër, nëse ju ofrohen informacione dhe oferta përkatëse, krijohet një ID unike e ofertës. Kjo ID oferte transferohet gjithashtu tek ofruesi ynë i shërbimit së bashku me llojin e ngjarjes (p.sh. shfaqur, klikuar, navigimi ka filluar), llojin e ekranit (p.sh. njësia kryesore, aplikacioni) dhe vulën kohore të ndërveprimit me ofertën për të verifikuar procesin e faturimit.

Nëse mbërrini dhe parkoni në pika të caktuara POI, ne i transferojmë gjithashtu të dhënat e mëposhtme në lidhje me këtë ngjarje tek ofruesi ynë i shërbimit, në mënyrë që ai të masë efektivitetin e përmbajtjes së palëve të treta dhe të përmirësojë shërbimet e ofruara: Pozicioni GPS i parkimit me gjerësi/gjatësi të paqartë gjeografike përtej 4 shifrave pas presjes dhjetore (pa të dhëna të sakta

për vendndodhjen) dhe dita e ngjarjes së parkimit (pa vulë të saktë kohore) së bashku me ID-në e pajisjes dhe ID-në e ofertës.

Për më tepër, nëse ofertat dhe informacionet nga automjeti dërgohen drejtpërdrejt në aplikacionin Bluelink si njoftime shtytëse, ne përpunojmë edhe ID-në e profilit tuaj të përdoruesit, p.sh. adresën tuaj të emailit.

Ne përpunojmë të dhënat tuaja personale për qëllimin e përmbushjes së Shërbimeve tona (Neni 6 (1) b) GDPR.

4.3.3. Njohja zanore

Njohja zanore ju mundëson të përdorni komanda me zë për të hyrë dhe kontrolluar sistemin e info-argëtimit dhe për të hartuar dhe dërguar mesazhe me tekst nëpërmjet një pajisjeje celulare të lidhur.

Për këtë funksion, në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut përpunohen dhe dërgohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: regjistrimi i zërit, të dhënat e vendndodhjes (koordinatat GPS), pika e interesit (POI) dhe ID-ja e përdoruesit të Cerence-s.

Kjo e fundit është një ID unike për t'u regjistruar në serverin e Cerence GmbH, Aachen, Gjermani, përpunuesi ynë i të dhënave për këto shërbime specifike.

Nuk ka asnjë lidhje midis ID-së së përdoruesit të Cerence-s dhe Numrit të Identifikimit të Automjetit (VIN) ose ndonjë identifikuesi tjetër, që do të thotë se Cerence GmbH nuk mund ta identifikojë një person fizik nga të dhënat e transmetuara në të.

Pasi të ndizni automjetin, njohja zanore aktivizohet si parazgjedhje në modalitetin online. Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

Kur përdorim njohjen zanore online, ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut.

Përveç kësaj, mbledhim kampionet e zërit dhe koordinatat GPS dhe i ruajmë ato deri në 90 ditë në mënyrë që të kryejmë dhe të përmirësojmë shërbimin e njohjes zanore.

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së) dhe kur kjo ka lidhje me përmirësimin e Shërbimeve bazuar në interesat tona legjitime përkatëse (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

Kur përdorni funksionin e njohjes zanore online, kampionet tuaja të zërit dhe koordinatat GPS përpunohen nga ofruesi ynë i shërbimeve Cerence GmbH, Aachen, Gjermani (përpunuesi i të dhënave) dhe nën-përpunuesit e tij, të cilët mund të ndodhen në vende jashtë BE-së/ZEE-së dhe mund të mos garantojnë një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave.

Mund ta çaktivizoni njohjen zanore online dhe të përdorni shërbimet e njohjes zanore në modalitet jashtë linje, ku nuk transmetohen të dhëna jashtë automjetit tuaj.

Nëse nuk dëshironi që t'i përpunojmë kampionet e zërit dhe koordinatat GPS, mund të përdorni njohjen zanore jashtë linje, e cila nuk përdor kampionet tuaja të zërit dhe koordinatat GPS për të përmirësuar shërbimin e njohjes zanore.

4.3.4. Diagnostikimi i automjetit

Diagnostikimi i automjetit mbledh kodet aktive të problemeve (d.m.th. mesazhet e defekteve të automjetit) nga të gjitha njësitë e kontrollit të integruara në automjetin tuaj, së bashku me numrin e identifikimit të automjetit (VIN).

Kodet aktive të problemeve dhe numri VIN dërgohen në serverin tonë për analiza të mëtejshme.

Në paragrafin "Diagnostikimi i automjetit" të sistemit të info-argëtimit, mund të shikoni të gjitha kodet aktive të defekteve për automjetin tuaj.

Ne i përdorim këto të dhëna për t'ju ofruar informacion nëse ka ndonjë problem me automjetin.

I përpunojmë të dhënat personale për Diagnostikimin e automjetit me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b i GDPR-së).

Në masën që na kërkohet nga ligji, ne i përpunojmë të dhënat personale të lartpërmendura për monitorimin e produkteve dhe për t'u pajtuar me kërkesat e sigurisë së produktit (Neni 6 (1) c) i GDPR-së).

Për informacion mbi përpunimin e të dhënave të mësipërme për përmirësimin dhe zhvillimin e produkteve, shihni edhe paragrafin [4.5](#) më poshtë.

4.3.5. Connected Routing

Funksioni "Connected Routing" lejon parashikime më të sakta të trafikut, kohë më të sakta të mbërritjes dhe rillogaritje më të besueshme të itinerarit duke i përpunuar të dhënat përkatëse në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut, në vend që të jetë vetëm në sistemin tuaj të info-argëtimit.

Për këtë funksion, në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut përpunohen dhe dërgohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), të dhënat e vendndodhjes (koordinatat GPS) dhe të dhënat e navigimit (p.sh. trafiku në kohë reale; modeli i informacionit të trafikut).

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.3.5.1. Itinerari i preferuar

Udhëzimi i itinerarit të preferuar ju lejon të krahasoni itineraret tuaja të përshkuara shpesh midis një pike fillestare specifike dhe destinacionit, për t'ju ofruar një llogaritje të itinerarit që përputhet me preferencat tuaja.

Për këtë funksion, në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut përpunohen dhe dërgohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: karta SIM e automjetit tuaj (ICCID) dhe itineraret tuaja të përshkuara shpesh, duke përfshirë informacionin e destinacionit dhe të dhënat e itinerarit aktual.

Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për qëllimin e përmbushjes së Shërbimeve tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.3.5.2. Përshtypjet rreth ndihmës me navigimin

Nëpërmjet sistemit të info-argëtimit, mund t'ju kërkohet të jepni përshtypjet tuaja për të vlerësuar se sa të kënaqur jeni me udhëzimet tona për itinerarin dhe informacionet e vendndodhjes.

Për këtë funksion, përpunojmë të njëjtat kategori të dhënash personale si në 4.3.1., si edhe vlerësimin tuaj të kënaqësisë.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave për këto qëllime është interesi legjitim i Hyundai-t për përmirësimin e Shërbimeve (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

4.3.6. Përditësimi OTA (Over-the-Air)

Përditësimet OTA ju lejojnë të merrni përditësime të softuerit me valë ("over-the-air") ("Përditësimet OTA") për sistemin e automjetit, si dhe për hartën dhe sistemin e info-argëtimit.

Sistemi juaj i info-argëtimit do të kontrollojë rregullisht nëse janë të disponueshme versione të reja të softuerit dhe do të shkarkojë automatikisht çdo përditësim të disponueshëm të softuerit në automjetin tuaj e do të përgatisë instalimin përkatës.

Ju mund të zgjidhni nëse do ta përfundoni Përditësimin OTA tani ose më vonë.

Mund ta çaktivizoni këtë veçori duke çaktivizuar çelësin në sistemin e info-argëtimit ("Cilësimet" -> "Bluelink" -> "Cilësimet e privatësisë").

Ose mund të çaktivizoni lidhjen e Bluelink-ut nëpërmjet sistemit të info-argëtimit në automjetin tuaj ("Cilësimet" -> "Bluelink-u" -> "Çaktivizo Bluelink-un").

Megjithatë, nëse i çaktivizoni Përditësimet OTA, automjeti ose shërbimet e ofruara (si sistemet e lidhura me sigurinë, sistemi i info-argëtimit, Bluelink-u) mund të mos funksionojnë siç duhet.

4.3.6.1. Përditësimi OTA i sistemit të automjetit

Ne mund t'ju ofrojmë Përditësimet OTA në lidhje me sistemin e automjetit për arsye dhe qëllime të ndryshme, veçanërisht për të ndrequr një defekt brenda periudhës së garancisë, brenda fushës së garancisë së prodhuesit ose për arsye të tjera të lidhura me sigurinë.

Gjithashtu, ne do të garantojmë efikasitetin e vendosjes dhe monitorimit të përditësimeve OTA për sistemin e automjetit.

Për këtë qëllim, në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut përpunohen dhe dërgohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), historiku i përdorimit (Përditësimi OTA), informacioni diagnostikues (kodet e defekteve, rezultati OTA, rezultati i rikuperimit të softuerit) dhe informacioni i versionit të softuerit (njësia e kontrollit elektronik). Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për të përmbushur detyrimet ligjore të prodhuesit të automjetit (Neni 6 (1) c) i GDPR-së (p.sh. në fushën e kërkesave të sigurisë për produktin)), si dhe për ofrimin e Shërbimeve tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së dhe duke u bazuar në interesin tonë legjitim për menaxhimin efikas të proceseve tona të përditësimit OTA (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

4.3.6.2. Përditësimi OTA i hartave dhe sistemit të info-argëtimit

Përditësimet OTA të hartave dhe të sistemit të info-argëtimit ju mundësojnë të merrni përditësimet më të fundit të hartave dhe të softuerit të info-argëtimit të automjetit.

Për këtë funksion, në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut përpunohen dhe dërgohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: Numri i identifikimit të automjetit (VIN), prodhuesi i njësisë kryesore, modeli i njësisë kryesore, versioni i firmuerit të njësisë kryesore, versioni i sistemit të njësisë kryesore, operatori i rrjetit celular, emri i modelit të automjetit, viti i modelit të automjetit, rajoni i automjetit dhe gjuha juaj e zgjedhur.

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.3.7. Qendra e njoftimeve

Qendra e njoftimeve na lejon t'ju dërgojmë informacione të rëndësishme për automjetin tuaj.

Do ta përdorim këtë shërbim vetëm për informacione të rëndësishme.

Informacioni do të shfaqet si një dritare kërcyese në sistemin e info-argëtimit të makinës.

Për këtë funksion përpunohen këto kategori të të dhënave personale: statusi i leximit; koha e leximit.

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.3.8. Kalendari

Kalendari ju lejon të sinkronizoni kalendarin tuaj të Google ose Apple në telefonin tuaj inteligjent me funksionin e integruar të kalendarit të sistemit të info-argëtimit të automjetit, në mënyrë që ta përdorni për të vendosur destinacionin e navigimit.

Për këtë funksion, në mjedisin tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut përpunohen dhe dërgohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: adresa e emailit, ID-ja e kalendarit, numri i telefonit, kodi i Google/fjalëkalimi i iCloud-it dhe regjistrimet në kalendar (p.sh. titulli i orarit, data/ora, adresa, kujtesa, frekuentimi etj.).

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.3.9. Funksioni i pëlqimeve

Funksioni i pëlqimeve për muzikën me USB dhe Bluetooth dhe radion ju lejon të zgjidhni dhe të krijoni një listë dëgjimi me këngët tuaja të preferuara.

Mund t'i pëlqesh ose të mos i pëlqesh këngët nëpërmjet butonit të "pëlqimit" ose të "mospëlqimit" të integruar në funksionin muzikor të sistemit të info-argëtimit.

Për këtë funksion, përpunohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: lloji i burimit (muzikë me USB, radio, muzikë me Bluetooth), emri i këngës, artistit dhe albumit, informacionet e pëlqimit/mospëlqimit, informacioni i vendndodhjes (GPS), temperatura e ajrit të ambientit, shpejtësia e automjetit, moti (bazuar në vendndodhjen tuaj aktuale) dhe informacioni për orën.

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së) dhe për interesin tonë legjitim në ofrimin e Shërbimeve (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

4.3.10. Transmetimi muzikor

Me veçorinë e transmetimit muzikor, mund të transmetoni muzikë në automjetin tuaj drejtpërdrejt nga disa shërbime të transmetimit muzikor nëpërmjet sistemit të info-argëtimit. Për ta përdorur këtë veçori, ju nevojitet një abonim i vlefshëm për shërbimin përkatës të transmetimit muzikor dhe telefoni juaj me aplikacionin Bluelink të instaluar për procesin e aktivizimit.

Për ta lidhur llogarinë tuaj me shërbimin e zgjedhur të transmetimit muzikor, kredencialet tuaja të hyrjes përpunohen fillimisht nga platforma e transmetimit muzikor dhe më pas transferohen te ne në formë të pseudonimizuar, përpara se të ruhen në mjedisin tonë të Bluelink-ut në renë kompjuterike.

Informacioni rreth përmbajtjes muzikore që kërkoni dhe zgjidhni transferohet nga automjeti në mjedisin tonë të Bluelink-ut në renë kompjuterike. Më pas, i dërgohet një kërkesë platformës përkatëse të transmetimit muzikor, e cila më pas ofron përmbajtjen muzikore drejtpërdrejt në automjet. Përmbajtja muzikore e luajtur së fundi, ruhet përkohësisht në sistemin e automjetit.

Për këtë qëllim, përpunohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: të dhënat e vërtetimit të përdoruesit (p.sh. kredencialet e identifikimit të pseudonimizuara për llogarinë e platformës së transmetimit, ID-ja e pajisjes, ID-ja e përdoruesit), informacioni i shërbimit (kodi i autorizimit të shërbimit, statusi i

abonimit, të dhënat e hyrjes, ID-ja e shërbimit, ID-ja e sesionit), informacioni i automjetit (numri VIN ose ID-ja e automjetit, lloji i motorit, vendi i shitjes, emri i modelit, viti i modelit, platforma e njësisë kryesore, modeli i njësisë kryesore) si dhe informacione rreth përmbajtjes muzikore të kërkuar (p.sh. identifikuesi unik, lloji, emri, titulli, artisti, emri i albumit, zhanri, kohëzgjatja, data e përmbajtjes, URL-të).

Llogaria juaj e transmetimit të platformës e ruajtur në automjet është e lidhur me profilin tuaj individual të përdoruesit në automjet. Fshirja e profilit tuaj të përdoruesit do të shkëpusë automatikisht llogarinë e transmetimit të platformës nga automjeti.

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të përmbushim Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.4. Ofrimi i Shërbimeve të Bluelink-ut - Aplikacioni

4.4.1. Shërbimet në distancë

Nëpërmjet aplikacionit ne do t'ju ofrojmë shërbimet e mëposhtme në distancë. Ato do të aktivizohen si parazgjedhje, nëse nuk çaktivizohen veçmas ose tërësisht:

- Kyçja dhe shkyçja në distancë (mund të kyçni dhe shkyçni dyert e automjetit; *të gjitha modelet Hyundai*)
- Ajrosja e dritareve në distancë (mund t'i hapni dhe t'i mbyllni dritaret e automjetit tuaj në distancë për qëllime ajrosjeje; vetëm për disa modele Hyundai)
- Boria dhe dritat në distancë (ju mund t'i aktivizoni ju mund të aktivizoni nga distanca si fenerët ashtu edhe zhurmën e borisë së automjetit tuaj; *vetëm për disa modele Hyundai*)
- Kontrolli në distancë i dritave (ju mund të ndizni nga distanca fenerin e automjetit tuaj; *vetëm për disa modele Hyundai*)
- Karikimi në distancë (mund të aktivizoni në distancë funksionin e karikimit të baterisë elektrike; *të gjitha modelet Hyundai EV dhe PHEV*)
- Karikimi i planifikuar (mund të vendosni në distancë orarin e karikimit të baterisë elektrike (*të gjitha modelet Hyundai EV dhe PHEV*) duke përfshirë temperaturën e synuar; *të gjitha modelet Hyundai EV*)
- Kontrolli i klimës në distancë (mund të vendosni temperaturën dhe të aktivizoni kondicionerin në distancë; *të gjitha modelet Hyundai EV*)
- Hapja dhe mbyllja në distancë e kapakut të karikimit (mund ta hapni dhe mbyllni kapakun e karikimit të automjetit tuaj në distancë; *vetëm për disa modele Hyundai EV; jo për modelet Hyundai PHEV*)
- Kontrolli në distancë i dritave të bllokazhit / dritave anësore (mund t'i fikni dritat në distancë nga aplikacioni kur automjeti ka mbetur me dritat e bllokazhit dhe/ose dritat anësore të ndezura; *vetëm për disa modele Hyundai*)
- Kondicionimi i baterisë në distancë (ju mund të optimizoni temperaturën e baterisë për të përmirësuar performancën e karikimit të automjetit; *vetëm*

për disa modele elektrike Hyundai)

- Orari i nisjes (ju mund të aktivizoni klimën e planifikuar duke vendosur orarin e nisjes; *vetëm për disa modele elektrike Hyundai)*
- Rryma e karikimit (ju mund të rregulloni rrymën e dhënë nga karikuesi i ngadaltë; *vetëm për disa modele elektrike Hyundai)*
- Gjej makinën time (mund të lokalizoni pozicionin e parkimit të automjetit tuaj Hyundai në hartën e integruar; *të gjitha modelet Hyundai)*
- Dërgo te makina (mund të kërkoni në internet për pikat e interesit (POI) dhe të dhënat e adresës për t'i dërguar rezultatet e kërkimit nga aplikacioni i smartfonit në sistemin e info-argëtimit të makinës)
- POI-ja për makinën time (sinkronizon POI-në tuaj të ruajtur midis sistemit të info-argëtimit dhe aplikacionit tuaj; *të gjitha modelet Hyundai)*
- Last Mile Navigation (dërgon vendndodhjen aktuale të automjetit tuaj dhe informacionin e destinacionit tuaj (p.sh. emrin, adresën, të dhënat e vendndodhjes gjeografike) te smartfoni juaj për t'ju orientuar të lëvizni nga vendi i parkimit deri në destinacion nëpërmjet Google Maps; *të gjitha modelet Hyundai)*
- First Mile Navigation (dërgon vendndodhjen aktuale të automjetit tuaj (p.sh. emrin, adresën, të dhënat e vendndodhjes gjeografike) te automjeti juaj nëpërmjet Google Maps; *të gjitha modelet Hyundai)*
- Modaliteti i parkimit "valet" (mbron informacionin tuaj privat të info-argëtimit duke shfaqur vetëm ekranin e modalitetit "valet" në sistemin e info-argëtimit, përveçse kur vendosni fjalëkalimin që keni zgjedhur më parë; dërgon te smartfoni juaj informacione për statusin aktual të modalitetit të parkimit "valet" (ndezur/fikur), vendndodhjen aktuale të automjetit (koordinatat GPS), datën e fillimit/mbarimit të modalitetit "valet", kohëzgjatjen/kilometrazhin/kohën e funksionimit të motorit në modalitetin "valet", shpejtësinë maksimale të automjetit, distancën e lëvizjes së automjetit dhe kohën bosh të motorit; *të gjitha modelet Hyundai EV)*
- Statusi i karikimit të baterisë (ju tregon statusin e karikimit të baterisë së motorit elektrik; *të gjitha modelet Hyundai EV dhe PHEV)*
- Njoftimet shtytëse për raste të caktuara përdorimi (aplikacioni dërgon njoftime shtytëse në smartfonin tuaj në raste të caktuara, për shembull: automjeti juaj Hyundai është shkyçur dhe është aktivizuar alarmi i vjedhjes në të, xhamat e automjetit janë të hapura, alarmi i sediljeve të pasme, alarmi i motorit në punë pa marsh, alarmi i shkarkimit të baterisë me tension të lartë, statusi i kontrollit të klimës, statusi i karikimit, statusi i përditësimit të softuerit, aktivizimi/çaktivizimi i modalitetit të parkimit "valet" etj.; *të gjitha modelet Hyundai, specifikimet ndryshojnë në varësi të vendit ose modelit të automjetit)*

Mund t'i çaktivizoni veçmas të gjitha Shërbimet në distancë.

Për t'ju ofruar Shërbimet në distancë, pasi të jeni lidhur përmes aplikacionit, krijohet një lidhje midis automjetit tuaj dhe mjedisit tonë në renë kompjuterike të

Bluelink-ut, i cili kërkon përpunimin e disa të dhënave të caktuara në lidhje me automjetin, duke përfshirë adresën IP të kartës SIM të automjetit, numrin e identifikimit të automjetit (VIN) dhe të dhëna të tjera që lidhen me përdoruesin e aplikacionit (adresa IP e pajisjes suaj, kodi PIN dhe informacione të tjera të llogarisë së përdoruesit, si p.sh. emri juaj i përdoruesit).

Për të ofruar Shërbimet në distancë kërkohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të caktuara në lidhje me automjetin tuaj duke përfshirë një fjalëkalim, numrin e identifikimit të automjetit (VIN) dhe të dhënat e vendndodhjes (p.sh. koordinatat GPS për "Gjej makinën time"), identifikuesin e kartës së qarkut të integruar të kartës SIM të automjetit (ICCID), të dhënat e adresës dhe të dhënat teknike që lidhen me automjetin (p.sh. informacionet për statusin e automjetit si ndezur/fikur, shpejtësia e automjetit, statusi i dritave, statusi i kyçjes).

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.4.2. Informacione për statusin e automjetit nëpërmjet Bluelink-ut

Nëpërmjet aplikacionit, do t'ju ofrojmë informacionet e mëposhtme për statusin e automjetit:

- Raporti mujor i automjetit (ju jep informacion në lidhje me përdorimin e makinës suaj Hyundai dhe informacione diagnostikuese për jastëkët e ajrit, frenat, presionin e gomave etj. (shihni paragrafin [4.4.3](#)); *të gjitha automjetet Hyundai*)
- Përditësimi i statusit (ju jep informacione rreth statusit të makinës suaj Hyundai, p.sh. distanca deri në zbrazjen e serbatorit, niveli i karburantit, motori i ndezur/fikur, statusi i kyçjes së derës, statusi i kontrollit të klimës, dera e pasme e hapur/mbyllur, kofanoja e hapur/mbyllur, dritaret të hapura/mbyllura, tavani i hapur/mbyllur, gjendja e presionit të gomave, statusi i llambave (*të gjitha automjetet Hyundai*); statusi i karikimit të baterisë me tension të lartë, karikimi i planifikuar aktiv/joaktiv, kapaku i karikimit i hapur/mbyllur, statusi i ngrohjes së timonit, shkrija ndezur/fikur, ngrohja e xhamit të pasmë ndezur/fikur, ngrohja e pasqyrave anësore (*të gjitha automjetet Hyundai EV dhe PHEV*); kontrolli i planifikuar i klimës aktiv/joaktiv (*të gjitha automjetet Hyundai EV*))
- Monitori i pamjes rrethuese (mund të kërkonti fotografi të çastit nga pamja aktuale rreth automjetit tuaj Hyundai dy herë në dy orë dhe t'i ruani ato në pajisjen tuaj (smartfon) duke përfshirë kohën e shkrepjes së tyre)
- Udhëtimet e mia (ju ofron informacione në lidhje me përdorimin e automjetit Hyundai çdo muaj/ditë, duke përfshirë kohën e kaluar, kilometrazhin, shpejtësinë mesatare të automjetit, shpejtësinë maksimale të automjetit; *të gjitha automjetet Hyundai*)
- Konsumi i energjisë (ju jep informacione në lidhje me konsumin ditor dhe mujor të energjisë të automjetit tuaj Hyundai, duke përfshirë konsumin total dhe mesatar të energjisë, distancën e drejtimit të automjetit dhe rikuperimin e energjisë; *të gjitha automjetet Hyundai EV*)

Për t'ju ofruar informacionet për statusin e automjetit, pasi të jeni lidhur nëpërmjet aplikacionit, krijohet një lidhje midis automjetit tuaj dhe mjedisit tonë në renë kompjuterike të Bluelink-ut, i cili kërkon përpunimin e të dhënave të

caktuara të lidhura me automjetin, duke përfshirë adresën IP të kartës SIM të automjetit, numrin e identifikimit të automjetit (VIN) dhe të dhëna të tjera që lidhen me përdoruesin e aplikacionit (adresa IP e pajisjes suaj, kodi PIN dhe informacione të tjera të llogarisë së përdoruesit, si p.sh. emri juaj i përdoruesit). Për të ofruar informacione për statusin e automjetit kërkohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të caktuara në lidhje me automjetin tuaj (p.sh. koha e drejtimit, kilometrazhi, shpejtësia mesatare e automjetit, shpejtësia maksimale e automjetit) dhe të dhëna teknike të lidhura me automjetin (p.sh. të dhënat për statusin e automjetit, si p.sh. motori i ndezur/fikur, statusi i kyçjes së derës etj., siç janë renditur më sipër).

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

Ne nuk kemi akses në asnjë të dhënë imazhesh që keni kërkuar në veçorinë e monitorit të pamjes rrethuese. Të gjitha të dhënat e imazhit transferohen në format të koduar në serverët tanë dhe fshihen pasi të dhënat të jenë transferuar në Aplikacion.

Ju lutemi, vini re se ju jeni një kontrollues i të dhënave sipas kuptimit të GDPR-së nëse regjistroni imazhe të një personi fizik ose imazhe që mund të gjurmojnë një person fizik (si p.sh. targat) kur përdorni këtë funksion.

Kjo do të thotë që ju jeni përgjegjës për të gjitha aktivitetet e përpunimit në këtë kontekst, veçanërisht keni detyrimin për të informuar subjektet e të dhënave (p.sh. kalimtarët ose shoferët e tjerë) për faktin se ata mund të regjistrohen në këto fotografi dhe se si i përpunoni të dhënat e këtij imazhi.

Nëse shkelni ndonjë dispozitë të GDPR-së, jeni në rrezik të kundërshtimeve dhe sanksioneve (duke përfshirë gjobat) nga autoritetet mbikëqyrëse. Ju lutemi shikoni Kushtet tona të përdorimit për më shumë informacion.

4.4.3. Ndarja e makinës me të tjerë

Ju mund t'i ndani Shërbimet në distancë me përdorues të tjerë nëpërmjet funksionit "Kërkesë për ta ndarë makinën me të tjerë" në aplikacion.

Në këtë rast, për të nisur dhe përpunuar kërkesën për ndarjen, ne përpunojmë të dhëna të caktuara që lidhen me automjetin dhe llogarinë e përdoruesit, si kodi PIN, numri i identifikimit të automjetit (VIN), emri juaj i përdoruesit dhe numri i telefonit të përdoruesit tjetër.

Informacioni i kërkesës për ndarje, si emri dhe kodi PIN, do të transmetohen dhe do të përpunohen në aplikacionin e përdoruesit tjetër.

Përdoruesi tjetër mund ta përdorë aplikacionin në të njëjtën mënyrë si ju. Ai/ajo mund të përdorë edhe funksionin "Gjej makinën time".

Ne i përpunojmë të dhënat personale për ndarjen e Shërbimeve në distancë me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së) dhe për interesat tona legjitime në ofrimin e Shërbimeve (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

Vini re se kur e përdorni këtë shërbim, do të ndani me përdoruesit e tjerë të gjitha të dhënat tuaja personale, duke përfshirë të dhënat tuaja të identifikimit, që ruhen në aplikacion.

Ju mund ta çaktivizoni këtë funksion në çdo kohë. Çaktivizimi ndalon ndarjen e të dhënave dhe ne do t'i fshijmë të gjitha të dhënat e ndara në aplikacionin e përdoruesit tjetër.

4.4.4. Shërbimet e sinjalizimit

Kur aktivizohen në aplikacion, shërbimet e sinjalizimit ju mundësojnë të merrni njoftime në lidhje me cilësimet tuaja të zgjedhura.

Ne ju ofrojmë shërbimet e mëposhtme të sinjalizimeve përmes aplikacionit:

- Sinjalizimi i rrethimit gjeografik (ju mundëson të merrni njoftime në aplikacion nëse automjeti del nga një zonë e lejuar ose hyn në një zonë të kufizuar. Ju mund t'i vendosni kufijtë për zonat e lejuara dhe zonat e kufizuara në aplikacion)
- Sinjalizimi i shpejtësisë (ju mundëson të merrni njoftime në aplikacion nëse automjeti e tejkalon kufirin e shpejtësisë që keni paracaktuar në aplikacion)
- Sinjalizimi i intervaleve kohore (ju mundëson të merrni njoftime në aplikacion nëse automjeti përdoret jashtë intervaleve kohore që keni paracaktuar në aplikacion)
- Sinjalizimi "valet" (ju mundëson të merrni njoftime në aplikacion nëse automjeti juaj udhëton përtej kufirit të zgjedhur të distancës, kufirit të shpejtësisë dhe afatit kohor bosh të motorit që keni paracaktuar në aplikacion. Distanca e lejuar e udhëtimit llogaritet nga vendi ku është aktivizuar sinjalizimi)
- Sinjalizimi i kohës bosh të motorit (ju mundëson të merrni njoftime në aplikacion nëse automjeti juaj drejtohet përtej kufirit të kohës bosh që keni paracaktuar në aplikacion)

Për këtë qëllim, ne mbledhim dhe përpunojmë kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: numri i identifikimit të automjetit (VIN), vula e datës dhe orës, të dhënat e GPS-së, informacioni i statusit të sinjalizimit (p.sh. statusi i aktivizimit, ora e fillimit dhe mbarimit të statusit të sinjalizimit, koha e përdorimit, koha e kilometrazhit, koha bosh e motorit, shpejtësia maksimale, distanca e përshkuar), treguesit e automjetit (p.sh. vendndodhja, shpejtësia, koha, saktësia, drejtimi), zonat e zgjedhura të lejuara, zonat e zgjedhura të kufizuara, kufiri i zgjedhur i shpejtësisë, intervalet kohore të zgjedhura, kufiri i zgjedhur i distancës dhe kufiri i zgjedhur i kohës bosh të motorit.

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.4.5. Shërbimet e tjera të bazuara te vendndodhja

- Shikoni udhëtimet e mëparshme
- Dërgoni një destinacion te makina për një udhëtim dhe shtoni pika turistike në një udhëtim të planifikuar
- Gjeni pikat tuaja të interesit (POI) më të preferuara dhe më të fundit
- Ndani pikën e interesit (POI)

Ofrimi i këtyre Shërbimeve në distancë kërkon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të caktuara që lidhen me automjetin, si p.sh. të dhënat e vendndodhjes së automjetit (koordinatat GPS).

Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për t'ju ofruar këto shërbime të tjera të bazuara te vendndodhja dhe me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.4.6. Profili i përdoruesit të Bluelink-ut

Profili i përdoruesit të Bluelink-ut ju lejon të krijoni kopje rezervë të profilit tuaj, duke përfshirë cilësime të automjetit për t'i aplikuar në automjete të ndryshme. Nëse dy ose më shumë shoferë përdorin të njëjtin automjet, por preferojnë cilësime të ndryshme (p.sh. për pozicionin e sediljeve, audion ose pamjen e hartës etj.), këto cilësime individuale mund të ruhen deri në dy profile përdoruesi plus një profil vizitori për automjet.

Për çdo profil përdoruesi, kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale përpunohen dhe dërgohen në mjedisin e resë kompjuterike të Bluelink-ut: Numri i identifikimit të automjetit (VIN) tuaj dhe të automjetit të synuar (nëse është e përshtatshme), numri i drejtuesit të automjetit, numri i llogarisë, numri i telefonit, fotografia e përdoruesit, të dhënat e profilit së bashku me lidhjen telefonike, cilësimet e datës/orës, cilësimet e përgjithshme, cilësimet e zërit, cilësimet e ekranit, cilësimet e njohjes zanore, cilësimet e radios, cilësimet e automjetit, cilësimet e navigimit dhe pikat e interesit (POI).

Ne i përpunojmë të dhënat personale me qëllim që të kryejmë Shërbimet tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.4.7. Përdorimi i Touch ID dhe Face ID (iOS) ose i gjurmës së gishtit dhe njohjes së fytyrës (Android)

Ju mund të përdorni funksione të caktuara të aplikacionit tonë me Touch ID ose Face ID (iOS) ose me gjurmën e gishtit dhe njohjen e fytyrës (Android), në vend të kodit PIN.

Të dhënat biometrike ruhen vetëm në nivel lokal në smartfonin tuaj; nuk na transmetohen neve dhe ne nuk mund t'i aksesojmë këto të dhëna.

I vetmi informacion që transmetohet në aplikacionin tonë nga një funksion i sistemit të smartfonit tuaj është nëse verifikimi i të dhënave biometrike ishte i suksesshëm.

Ju mund ta çaktivizoni përdorimin e Touch ID ose Face ID (iOS) ose të gjurmës së gishtit dhe njohjes së fytyrës (Android) në çdo kohë në aplikacionin tonë.

4.4.8. Firebase Crashlytics

Për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin e aplikacionit dhe të Shërbimeve tona, mbështetemi në analizën e raporteve anonime të ndërprerjeve aksidentale.

Për këtë qëllim përdorim "Firebase Crashlytics", një shërbim i Google Ireland Ltd., Google Building Gordon House, Barrow Street, Dublin 4, Irlandë.

Për të na ofruar raporte të anonimizuara të ndërprerjeve aksidentale, Firebase Crashlytics mbledh informacionet e mëposhtme në rast të një ndërprerjeje ose mosfunksionimi të aplikacionit dhe mund ta transmetojë atë te serverët e Google në SHBA: gjendja e aplikacionit në momentin e ndërprerjes, instalimi i UUID-së, gjurmët e ndërprerjes, prodhuesi dhe sistemi operativ i pajisjes celulare, si dhe mesazhet e regjistrimit të fundit.

Raportet e ndërprerjeve aksidentale që na jepen nuk përmbajnë asnjë të dhënë personale në bazë të së cilës ne mund të gjurmë identitetin e një përdoruesi. Firebase Crashlytics e ruan informacionin e mbledhur për 90 ditë.

Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për këto qëllime bazuar në interesin tonë legjitim për të garantuar dhe optimizuar sigurinë dhe stabilitetin e aplikacionit dhe të Shërbimeve tona (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

Për më shumë informacion rreth Firebase Crashlytics dhe se si Google i përpunon të dhënat tuaja personale, referojuni lidhjeve të mëposhtme:

<https://firebase.google.com/terms/crashlytics>
<https://firebase.google.com/support/privacy/>

4.4.9. Hyundai Digital Key (Çelësi dixhital i Hyundai-t)

Funksioni i Hyundai Digital Key ju lejon ta zhblokoni, ta kyçni, ta ndizni dhe ta drejtoni automjetin tuaj me smartfonin tuaj ose me pajisje të tjera inteligjente, pa pasur nevojë të mbani një çelës fizik me vete. Gjithashtu, ju lejon t'i ndani dhe t'i menaxhoni Hyundai Digital Keys me deri në tre pajisje shtesë, p.sh. ato që i përkasin familjes dhe miqve.

Për këtë qëllim, përpunohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale për të vërtetuar dhe shpërndarë siç duhet Hyundai Digital Keys në pajisjet inteligjente dhe për të garantuar sigurinë e shërbimit dhe të sistemeve të përfshira:

Informacionet e përdoruesit (si ID-ja e përdoruesit, emri i profilit, adresa e emailit, numri i telefonit), informacionet e pajisjes inteligjente (si ID-ja e pajisjes, emri i pajisjes, lloji i pajisjes, versioni i sistemit operativ, versioni i aplikacionit), informacionet e Hyundai Digital Key (siç është ID-ja e Hyundai Digital Key, statusi i Hyundai Digital Key, lloji i Hyundai Digital Key, autorizimi/profili i aksesit, ID-ja e automjetit, ID-ja e çelësave fizikë, numri i çelësave të përbashkët); për Hyundai Digital Keys të përbashkët: informacione shtesë, si data e fillimit dhe mbarimit (ose afati fiks) i përdorimit të Hyundai Digital Key, emri i përdoruesit të Hyundai Digital Key të përbashkët, politika e vërtetimit të përdoruesit/profili i autorizimit siç specifikohet nga ju, informacionet diagnostikues (kodet e gabimit) dhe informacioni i statusit të automjetit.

Kur përdorni Hyundai Digital Key, pra për të kyçur, zhblokuar dhe ndezur automjetin, të dhënat shkëmbehen midis pajisjes celulare inteligjente dhe automjetit duke përdorur Komunikimin në fushë të afërt (NFC). Këto të dhëna nuk i transmetohen Hyundai-t ose Distributorit.

Ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale për qëllimin e kryerjes së Shërbimeve tona (Neni 6 (1) b) i GDPR-së).

4.5. Analiza e të dhënave për përmirësimin dhe zhvillimin e produktit

Hyundai mbledh dhe përpunon të dhëna telematike në lidhje me performancën, përdorimin, funksionimin dhe gjendjen e automjetit, në mënyrë që t'i përmirësojë dhe t'i zhvillojë produktet e tij, dhe i transferon këto të dhëna te distributorët e autorizuar të Hyundai-t, në mënyrë që edhe ata të mund t'i përpunojnë të dhënat për këto qëllime.

Të dhënat e përdorura për këto qëllime kufizohen përgjithësisht në të dhënat teknike.

Të dhënat që përdoren për të përmirësuar dhe zhvilluar motorin, automjetet hibride/EV dhe funksionet e tjera të automjetit përfshijnë ABS-në, statusin e ABS-së, informacionin e timonit, frenat e dorës, sistemin e kontrollit të tërheqjes, informacionin e grupit, rripin e sigurimit, pedalin e gazit, gjendjen e baterisë, kyçjen e dyerve, fenerët e përparmë, sinjalin tregues, sistemin e ndriçimit, sistemin e bagazhit pa duar, lartësinë e sediljes, tavanin, fshirëset e xhamave, navigimin (ndezur/fikur) dhe të dhëna të ngjashme teknike dhe kode defektesh siç përmenden në seksionin [4.3.4](#).

Ne mund të mbledhim informacion shtesë që mundëson identifikimin e një personi fizik (si p.sh. numrin VIN, të dhënat e llogarisë dhe të abonimit dhe, sipas nevojës dhe nëse është i aktivizuar, informacionin e GPS-së), me qëllim që të ofrohet efikasitet më i madh i analizës së të dhënave. Ne do t'i përpunojmë këto

të dhëna për qëllimet e lartpërmendura dhe për t'ju ofruar informacion të personalizuar për përdorimin e Shërbimeve tona prej jush.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja për këto qëllime është interesi legjitim i Hyundai në përmirësimin e Shërbimeve dhe zhvillimin e produkteve e të shërbimeve të reja (Neni 6 (1) f) i GDPR-së; p.sh. për të identifikuar keqfunksionimet teknike, për të analizuar performancën e automjeteve ose për të ofruar produkte a shërbime të përmirësuara për klientin).

4.6. Përpunimi i të dhënave për qëllime marketingu për produkte dhe Shërbime të ngjashme

Ne mund t'i përdorim të dhënat tuaja personale që kemi marrë drejtpërdrejt nga ju dhe regjistrimin tuaj në Shërbimet tona për qëllime marketingu të produkteve dhe/ose shërbimeve tona të ngjashme (p.sh. për t'ju njoftuar për Shërbime të reja ose për shërbime të tjera të ngjashme të Hyundai-t), me përjashtim të rasteve kur ju nuk keni pranuar përdorim të tillë të të dhënave.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave është Neni 6 (1) (f) i GDPR-së (interesat tona legjitime për t'ju informuar dhe për të promovuar Shërbimet tona).

Juve ju lind e drejta të kundërshtoni një përdorim të tillë në çdo kohë dhe çdo tarifim pa pagesë nëpërmjet lidhjes së çregjistrimit që përfshihet në çdo komunikim ose nëpërmjet informacionit të kontaktit në seksionin [3](#)

4.7. Përpunimi i të dhënave për qëllime që lidhen me sigurinë kibernetike të automjetit

Pasi të aktivizoni Shërbimet, në varësi të pajisjeve teknike të automjetit tuaj, ne mbledhim dhe përpunojmë të dhëna nga automjeti juaj në lidhje me ngjarjet e sigurisë, në mënyrë që të sigurohemi që automjetet dhe produktet tona i përmbushin standardet e duhura të sigurisë kibernetike.

Për këtë funksion, përpunohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale: numri i identifikimit të automjetit (VIN) dhe të dhënat e lidhura me ngjarjen e sigurisë (siç është vula kohore e ngjarjes së krijuar të sigurisë dhe informacioni nga dhe rreth komponentit / njësisë së kontrollit që kapi dhe zbuloi ngjarjen e sigurisë).

Të dhënat do të mbliidhen dhe ruhen në automjetin tuaj.

Nëse zbulohet një sinjal jonormal, të dhënat do të dërgohen në sistemet tona për analizim të mëtejshëm.

Nuk ka transferim të vazhdueshëm të të dhënave të tilla jashtë automjetit.

Pasi të dhënat të jenë transmetuar në sistemet tona, ne i përpunojmë dhe analizojmë të dhënat me qëllim parandalimin e kërcënimeve dhe dobësive të sigurisë kibernetike, duke iu përgjigjur dhe eliminuar kërcënimet dhe dobësitë e zbuluara që rrjedhin nga sulmet e mundshme të sigurisë kibernetike, si dhe për t'u siguruar që automjetet dhe produktet tona kanë një nivel përshtatshëm sigurie.

Përderisa një përpunim i tillë nuk është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve tona ligjore në fushën e sigurisë kibernetike (Neni 6 (1) c) i GDPR-së), baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja për këto qëllime është interesi legjitim i Hyundai-t në monitorimin e automjeteve tona për të garantuar dhe përmirësuar sigurinë e produkteve tona (Neni 6 (1) f) i GDPR-së).

Automjeti juaj do të ruajë periodikisht 100 ngjarjet e fundit të sigurisë të krijuara. Nëse ndodh një ngjarje e re sigurie, ngjarja më e vjetër e sigurisë dhe të dhënat

përkatëse do të fshihen. Informacione të mëtejshme rreth ruajtjes së të dhënave mund të gjenden në paragrafin 8 të këtij Njoftimi të privatësisë.

5. Çfarë aplikohet për të dhënat e subjekteve të tjera të të dhënave dhe për shitjen dhe transferimin e automjetit të një palë e tretë?

Kur i jepni makinën një personi tjetër ose kur gjatë përdorimit të Shërbimeve mund të mblidhen të dhënat e subjekteve të tjera të të dhënave (si p.sh. një shofer tjetër), duhet të siguroheni që subjektet e të dhënave të jenë të informuar siç duhet për përpunimin e të dhënave, siç përshkruhet këtu.

Kur e shisni ose e transferoni përgjithmonë automjetin të një palë e tretë, ju lutemi sigurohuni që ta çaktivizoni shërbimin në mënyrë që asnjë nga të dhënat tuaja personale të mos mund të aksesohet përmes sistemit të info-argëtimit (Cilësimet – Bluelink – Çaktivizo Bluelink).

Nëse nuk e çaktivizoni Bluelink, të dhënat mund të jenë ende të aksesueshme nga palë të treta përmes sistemit të info-argëtimit.

Të dhënat e llogarisë suaj në aplikacion nuk do të fshihen derisa të mbyllni llogarinë tuaj Hyundai.

6. Me kë ndahen të dhënat e mia?

Aksesi në të dhënat tuaja personale të Hyundai është i kufizuar për ata individë që duhet të njihen me to për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të punës.

Të dhënat tuaja personale mund të transferohen të marrësit dhe kategoritë e marrësve të listuar më poshtë për qëllimet përkatëse; këta marrës mund t'i përpunojnë ato për qëllimet e specifikuar:

- Distributorët e Hyundai-t - Ne do të veprojme si bashkë-kontrollor së bashku me distributorin e autorizuar të Hyundai-t në vendin ku keni kryer blerjen e automjetit tuaj për Shërbimet e mëposhtme: diagnostikimi i automjetit (seksioni [4.3.4](#)) dhe përmirësimi e zhvillimi i Produktit (seksioni [4.5](#)), si edhe në lidhje me monitorimin e produkteve tona dhe përgjegjësinë për produktin.
- Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale në cilësinë tonë si furnitor teknik dhe operacional i Shërbimeve dhe do t'u transmetojmë shpërndarësve të Hyundai-t të dhëna të caktuara personale.
- Distributori i Hyundai-t merr të dhënat tuaja personale për qëllime të shërbimit për klientët dhe të mirëmbajtjes, si dhe për zhvillimin e produktit.
- Ne dhe distributori i Hyundai-t lidhim një marrëveshje që rregullon veprimtarinë e përpunimit të të dhënave personale. Ne do t'ju ofrojmë informacion mbi përmbajtjen e një marrëveshjeje të tillë, në vijim të kërkesës përkatëse.
- Më shumë të dhëna të kompanisë për secilin prej distributorëve të Hyundai-t mund të gjenden nga Shtojca.
- Hyundai Motor Europe - Ne do të veprojme si bashkë-kontrollues me Hyundai Motor Europe GmbH, me seli në adresën Kaiserleipromenade 5, 63067 Offenbach, Germany, në lidhje me përditësimet OTA të sistemit të automjetit.

- Ne do t'i përpunojmë të dhënat tuaja personale në cilësinë tonë si furnitor teknik dhe operacional i Shërbimeve dhe do t'i transmetojmë Hyundai Motor Europe t të dhëna të caktuara personale.
- Hyundai Motor Europe është përgjegjëse për vendimet që lidhen me monitorimin e shpërndarjes së përditësimeve OTA të sistemit të automjeteve dhe për vetë këto monitorime.
- Ne dhe Hyundai Motor Europe lidhim një marrëveshje që rregullon përpunimin e të dhënave personale. Ne do t'ju ofrojmë informacion mbi përmbajtjen e një marrëveshjeje të tillë, në vijim të kërkesës përkatëse.
- Palët e tjera të treta private - Ne ua transmetojmë të dhënat tuaja personale subjekteve të caktuara private që na ndihmojnë të ofrojmë Shërbimet. Për shembull, ne mbështetemi te shërbimet e telekomunikacionit nga ofruesit e telekomunikacionit.
- Përpunuesit e të dhënave - Ne ua transmetojmë të dhënat tuaja personale palëve të treta, qofshin të lidhura apo jo me Hyundai-n, të cilat i përpunojnë në emër të Hyundai-t sipas udhëzimeve përkatëse për atë që është e nevojshme për qëllimet përkatëse të përpunimit. Përpunuesit e të dhënave do t'u nënshtrohen detyrimeve kontraktuale për të zbatuar masat e duhura të sigurisë teknike dhe organizative për t'i mbrojtur të dhënat personale dhe për t'i përpunuar ato vetëm sipas udhëzimeve.
 - ▶ Përpunuesi i të dhënave për BlueLink-un është Hyundai Autoever Europe, Kaiserleistraße 8A, 63067 Offenbach am Main, Gjermani.
 - ▶ Për Hyundai Live dhe shërbimin në distancë "Gjej makinën time", përpunuesi i të dhënave është: Hyundai Autoever Europe, Kaiserleistraße 8A, 63067 Offenbach am Main, Gjermani (p.sh. për hostimin dhe mbështetjen ose funksionimin e aplikacioneve përkatëse).
 - ▶ Për njohjen zanore, përpunuesit e të dhënave janë: Cerence GmbH, Jülicher Straße 376, 52070 Aachen, Gjermani; Hyundai Autoever Europe, Kaiserleistraße 8A, 63067 Offenbach am Main, Gjermani (p.sh. për aplikacionet përkatëse të ndihmës dhe të funksionimit).
 - ▶ Për shpërndarjen teknike të përditësimeve OTA të sistemit të automjetit, analizimit të ngjarjeve të sigurisë dhe për të garantuar proceset teknike për analizimin e të dhënave me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e produktit, përpunuesi i të dhënave është Hyundai Motor Company, 12, Heolleung-ro, Seocho-gu, Seul, Republika e Koresë.
 - ▶ Ne përdorim përpunues të të dhënave për shërbimet e qendrave telefonike.
 - ▶ Të gjithë përpunuesit e të dhënave më lart mund të përdorin gjithashtu nën-përpunues për ofrimin e shërbimeve përkatëse.
- Autoritetet qeveritare, gjykatat, këshilltarët e jashtëm dhe palët e treta të ngjashme që janë organe publike siç kërkohet ose lejohet nga ligji në fuqi.

7. **A transferohen të dhënat e mia jashtë vendit?**

Ne i transferojmë të dhënat tuaja jashtë territorit të BE-së/ZEE-së tek entitetet e Hyundai-t në Republikën e Koresë për qëllimet e përshkruara në seksionin 6.

Komisioni Evropian ka përcaktuar se territori i Koresë dhe i Mbretërisë së Bashkuar janë ndër juridiksionet që ofrojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Disa nga marrësit e të dhënave tuaja personale do të ndodhen ose mund të ushtrojnë veprimtarinë përkatëse jashtë vendit tuaj dhe jashtë territorit të BE-së/ZEE-së, si p.sh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (p.sh. nën-përpunuesit e Cerence), ku ligjet për mbrojtjen e të dhënave mund të ofrojnë një nivel të ndryshëm të mbrojtjes krahasuar me legjislacionin e zbatueshëm në juridiksionin e vendit tuaj dhe për të cilat nga Komisioni Evropian nuk ekziston një vendim për përshtatshmërinë përkatëse.

Në lidhje me transferimet e të dhënave për marrës të tillë jashtë BE-së/ZEE-së, ne ofrojmë masa mbrojtëse të përshtatshme, në veçanti, duke lidhur me marrësit marrëveshje për transferimin e të dhënave që përfshijnë klauzola standarde të miratuara nga Komisioni Evropian ose duke marrë masa të tjera për të siguruar një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave.

Një kopje e masës përkatëse që kemi marrë mund të gjendet nëpërmjet oficerit të mbrojtjes së të dhënave të Hyundai-t (shihni paragrafin [3.2](#) më lart).

8. Për sa kohë do të ruhen të dhënat e mia?

8.1. Të dhënat tuaja personale ruhen nga Hyundai dhe/ose ofruesit tanë të shërbimeve vetëm në masën që është e nevojshme për të përmbushur detyrimet tona dhe vetëm për kohën e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat janë mbledhur të dhënat personale, në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Në asnjë rrethanë të dhënat personale nuk do të ruhen pas mbylljes së llogarisë tuaj.

Kur Hyundai nuk do të ketë më nevojë t'i përpunojë të dhënat personale, ne do t'i fshijmë nga sistemet dhe/ose të dhënat tona dhe/ose do të ndërmarrim hapa për t'i anonimizuar siç duhet, në mënyrë që të mos të identifikoheni më nga të dhënat (përveç rastit kur na duhet të mbajmë informacione për të përmbushur detyrimet ligjore ose rregullatore të cilave Hyundai u nënshtrohet; p.sh. të dhënat personale të përfshira në kontrata, komunikime dhe letra biznesi mund t'u nënshtrohen kërkesave ligjore për ruajtjen e tyre, të cilat mund të kërkojnë që të ruhen deri në 10 vjet).

8.2. Ekzistojnë periudha specifike ruajtjeje për artikujt e mëposhtëm:

- Njohja zanore: kampionet e zërit dhe koordinatat GPS (shihni paragrafin [4.3.3](#) më lart) ruhen deri në 90 ditë.
- Hyundai drejtpërdrejt: të dhënat e vendndodhjes gjeografike (koordinatat GPS) dhe ID-ja e shërbimit (shihni paragrafin [4.3.2](#) më lart) ruhen deri në 93 ditë.
- Udhëtimet e mia: informacioni për përdorimin e automjetit tuaj i dhënë në "Udhëtimet e mia" është i disponueshëm deri në 90 ditë.

8.3. Mbyllja e llogarisë: Nëse zgjidhni ta mbyllni llogarinë (p.sh. duke vendosur preferencën përkatëse në sistemin e info-argëtimit të makinës ose në menynë e aplikacionit të "Llogaria ime"), të gjitha të dhënat personale që lidhen me llogarinë tuaj do të fshihen, përveçse nëse zbatohen periudhat e ruajtjes (shihni paragrafin [8.1](#) më sipër).

9. Çfarë të drejtash kam dhe si mund t'i ushtroj ato?

Nëse keni dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave tuaja personale, mund ta tërhiqni në çdo kohë me efekt për të ardhmen.

Një tërheqje e tillë nuk do të ndikojë në ligjshmërinë e përpunimit që ka ndodhur përpara tërheqjes së pëlqimit.

Distributori do të jetë pika e kontaktit për çdo kërkesë nga subjektet e të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në lidhje me këtë Njoftim privatësie dhe shtojcën e tij.

Megjithatë, ju do të keni të drejtë t'i ushtroni të drejtat tuaja sipas GDPR-së dhe ligjeve kombëtare për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me dhe ndaj secilit kontrollues.

Në bazë të ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, ju keni të drejtat e mëposhtme në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale.

Vini re se këto të drejta mund të kufizohen sipas ligjit kombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

- 9.1.** E drejta e aksesit: Ju keni të drejtën të merrni konfirmim nga ne nëse përpunohen apo jo të dhënat tuaja personale dhe, në një rast të tillë, të kërkonti akses në to. Ky informacion përfshin – ndër të tjera – qëllimet e përpunimit, kategoritë e të dhënave personale dhe marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve u janë dhënë ose do t'u zbulohen të dhënat tuaja personale. Megjithatë, kjo nuk është një e drejtë absolute dhe interesat e individëve të tjerë mund të kufizojnë të drejtën tuaj për akses. Gjithashtu keni të drejtë të merrni një kopje të të dhënave tuaja personale që po përpunohen. Për çdo kopje të mëtejshme që mund të kërkonti, ne mund të tarifojmë një tarifë të arsyeshme bazuar në kostot administrative.
- 9.2.** E drejta për korrigjim: Ju keni të drejtën për të korrigjuar çdo të dhënë personale të pasaktë në lidhje me ju. Në varësi të qëllimeve të përpunimit, ju keni të drejtën t'i përditësoni të dhënat personale të paplota, duke përfshirë edhe dhënien e një deklaratë plotësuese.
- 9.3.** E drejta për fshirje ("e drejta për t'u harruar"): Në rrethana të caktuara, ju keni të drejtën për fshirjen e të dhënave personale dhe ne mund të kemi detyrimin t'i fshijmë të ato.
- 9.4.** E drejta e kufizimit të përpunimit: Në rrethana të caktuara, ju keni të drejtën të vendosni një kufizim në përpunimin e të dhënave tuaja personale. Në këtë rast, të dhënat përkatëse do të shënohen dhe mund të përpunohen nga ne vetëm për qëllime të caktuara.
- 9.5.** E drejta për mbartjen e të dhënave: Në rrethana të caktuara, ju mund të keni të drejtën të merrni nga ne një kopje të të dhënave tuaja personale që na i keni dhënë, në një format të strukturuar, që përdoret zakonisht dhe të lexueshëm nga makineritë. Ju keni të drejtë, pa pengesa nga ne, t'i transferoni këto të dhëna ose të kërkonti të transferohen drejtpërdrejt nga ne te një subjekt tjetër.
- 9.6.** E drejta për të kundërshtuar: Në rrethana të caktuara, ju keni të drejtën të kundërshtoni, për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë dhe në çdo kohë, përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe neve do të na kërkohet që të mos i përpunojmë më ato.

Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, ju keni të drejtën ta kundërshtoni në çdo kohë përpunimin e të dhënave tuaja personale për një marketing të tillë, i cili përfshin profilizimin në masën që lidhet me një marketing të tillë të drejtpërdrejtë. Në këtë rast, të dhënat tuaja personale nuk do të përpunohen më nga ne për qëllime të tilla.

9.7. E drejta për t'u ankuar: Ju gjithashtu keni të drejtën të bëni një ankesë pranë autoritetit kompetent mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave në vendin tuaj të origjinës.

10. A jam i detyruar t'i jap të dhënat e mia?

Ju nuk keni asnjë detyrim ligjor ose kontraktual për të na dhënë të dhënat tuaja personale.

Për më tepër, nuk keni nevojë të jepni të dhënat tuaja personale për lidhjen e një kontrate. Megjithatë, nëse nuk i jepni të dhënat personale, ka mundësi që përdorimi i Shërbimeve tona të jetë i kufizuar për ju.

11. A mund ta çaktivizoj modalitetin online (modaliteti jashtë linje; modemi i fikur)?

Ju mund të zgjidhni ta çaktivizoni modalitetin online duke vendosur preferencën përkatëse.

Nëse modaliteti online çaktivizohet (modaliteti jashtë linje), të gjitha funksionet e Bluelink-ut çaktivizohen dhe për Bluelink-un nuk mblidhen më të dhëna personale, veçanërisht asnjë e dhënë për vendndodhjen gjeografike (koordinatat GPS). Në krye të ekranit të sistemit të info-argëtimit në automjet shfaqet një ikonë e modalitetit jashtë linje.

12. Si mund të ndryshohet ky Njoftim privatësie?

Ne mund ta ndryshojmë dhe/ose plotësojmë këtë Njoftim privatësie herë pas here në të ardhmen.

Ndryshime dhe/ose plotësime të tilla mund të jenë të nevojshme për shkak të zbatimit të teknologjive të reja ose prezantimit të shërbimeve të reja në veçanti. Ne do t'i publikojmë ndryshimet në faqet tona të internetit dhe/ose në sistemin e info-argëtimit të makinës suaj e në aplikacion.

13. Shtojcë: Lista e distributorëve të autorizuar të Hyundai-t

Austri

Hyundai ImportGesellschaft m.b.H.

Richard StraussStraße 14

1230 Vienna

Austri

Numri i regjistrimit tregtar: 47654f

datenschutz@hyundai.at

Belgjikë

NV Korean Motor Company SA

Pierstraat 229

2550 Kontich

Belgjikë

Numri i regjistrimit tregtar: BE0404273333

privacy@hyundai.be

Bosnjë e Hercegovinë

Hyundai-Auto BH d.o.o.

Branilaca Šipa 4C
71000 Sarajevo
Bosnjë e Hercegovinë
Numri i regjistrit tregtar: 65-01-0799-09

Bullgari

Industrial Commerce Ltd
1797 Sofia
260 Ring Road
Bullgari
Numri i regjistrit tregtar: 204502867
m.kamenova@hyundaibg.bg

Ishujt Kanarie

HYUNDAI CANARIAS, S.L.U.
C/ Lomo la Plana, 16
35.019. Las Palmas de Gran Canaria
Las Palmas
Numri i regjistrit tregtar: B76156504

dpo@domingoalonsogroup.com

Kroaci

Hyundai Hrvatska d.o.o.
Ljubljanska avenija 4C
10090 Jankomir
Grad Zagreb
Kroaci
Numri i regjistrit tregtar: HRSR.080961241
dubravka.posinovec@hyundai.hr

Qipro

CTC Automotive Ltd
Shacolas Emporium Park-Annex 4, 4 Verginas Street
2030 Nicosia
Qipro
Numri i regjistrit tregtar: HE145360
bluelink@ctcautomotive.com.cy

Republika Çeke

Hyundai Motor Czech s.r.o.
Siemensova 2717/4
155 00 Praha 5
Republika Çeke
Numri i regjistrit tregtar: 28399757
info@hyundai.cz

Danimarkë

Hyundai Bil Import A/S
Korsvej 1
6000 Kolding
Danimarkë
Numri i regjistrit tregtar: 14790993
GDPR@nc.dk

Finlandë

Hyundai Motor Finland OY
Kellokukantie 2
01300 Vantaa
Finlandë
Numri i regjistrimit tregtar: FI16337337
tietosuoja@hyundai.fi

Francë

Hyundai Motor France
Tour Nova - 71 Boulevard National
92250 La Garenne-Colombes
Francë
Numri i regjistrimit tregtar: 411 394 893
contact-donnees@hyundai.fr

Gjermani

Hyundai Motor Deutschland GmbH
Kaiserleipromenade 5
63067 Offenbach
Gjermani
Numri i regjistrimit tregtar: HRB 47293
datenschutz@hyundai.de

Greqi

Hyundai Hellas S.A.
31, Viltanioti Street
14564 Kifissia
Greqi
Numri i regjistrimit tregtar: 659601000
gdpr@hyundai.com.gr

Hungari

Hyundai Holding Hungary Kft
Cziffra György út 15
1182 Budapest
Hungari
Numri i regjistrimit tregtar: 01-09-881438
info@hyundai.hu

Islandë

BL ehf
Kauptúni 1
210 Garðabær
Islandë
Numri i regjistrimit tregtar: 630211-0500
gudrunh@hyundai.is

Irlandë

Hyundai Cars Ireland Limited
JFK Drive, Naas Road
Dublin, 12
Irlandë
Numri i regjistrimit tregtar: 211878
Darren.Byrne@hyundai.ie

Itali

Hyundai Motor Company Italy S.r.l.
Via Giovanni Bensi 11
20152, Milano
Itali
Numri i regjistrit tregtar: 6313170968
DPO@hyundai.it

Maltë

Meridian Enterprises Co. Ltd.
Pater House
168 Psaila Street
Birkirkara BKR 9077
Maltë
Numri i regjistrit tregtar: C3988
johan.micallef@meridian.com.mt

Moldavi

Pacific Motors SRL
Chisinau str. Calea Mosilor 5/1
Moldavi
Numri i regjistrit tregtar: 1014600041393

Holandë

Hyundai Motor Netherlands b.v.
Hub van Doorneweg 14
2171 KZ Sassenheim
Hollandë
Numri i regjistrit tregtar: 61506230
legal@hyundai-motor.nl

Norvegji

Hyundai Motor Norway AS
Alf Bjerckes vei 8
0582 Oslo
Norvegji
Numri i regjistrit tregtar: 914 315 816
kundeservice@hyundai.no

Poloni

Hyundai Motor Poland Sp. Z o.o.
ul. Woloska 24
02-675 Warszawa
Poloni
Numri i regjistrit tregtar: 0000067315
hyundai.dpo@wlaw.pl

Portugali

Hyundai Portugal, S.A.
Rua do Campo Alegre
1306-B Porto
Portugali
Numri i regjistrit tregtar: 500820384
privacidade@hyundai.pt

Rumani

Hyundai Auto Romania
Bd. Expozitiei, nr. 2, showroom Hyundai
etaj 1, sector 1, Bucuresti
Rumani
Numri i regjistrit tregtar: J40/15805/1994
daniela.avram@tiriacaauto.ro

Serbi

Hyundai Srbija d.o.o. Beograd
Milutina Milankovića 7V
11070 Novi Beograd
Serbi
Numri i regjistrit tregtar: 21114804

Sllovaki

Hyundai Motor Czech s.r.o., organizačná zložka Slovaki
Galvaniho 17/A
821 04 Bratislava
Republika Sllovake
Numri i regjistrit tregtar: 1610/B
dpo@hyundai.sk

Slloveni

Hyundai Avto Trade d.o.o. Ljubljana
Brnčičeva 45
1231 Ljubljana - Črnuče
Slloveni
Numri i regjistrit tregtar: 5526485
gdpr@hyundai.si

Spanjë

Hyundai Motor España S.L.U.
Calle Quintanapalla 2
28050 Madrid
Spanjë
Numri i regjistrit tregtar: B85754646
DPO@hyundai.es

Suedi

Hyundai Motor Sweden AB
Hyllie Stationsväg 42
215 32 Malmö
Suedi
Numri i regjistrit tregtar: 559441-2529
legal@hyundai.se

Zvicër

ASTARA MOBILITY SWITZERLAND AG
Brandbachstrasse 6
CH-8305 Dietlikon
Zvicër
Numri i regjistrit tregtar: CHE-262.166.165
dataprotection@hyundai.ch

MB

Hyundai Motor UK Limited
Ground Floor Birchwood Building Springfield Drive
Leatherhead Surrey KT22 7LP
Mbretëria e Bashkuar
Numri i regjistrimit tregtar: 05446560
dpo@hyundai.co.uk

Ukrainë

Hyundai Motor Ukraine LLC
1A Novokonstantynivska Str.,
04080 Kyiv
Ukrainë
Numri i regjistrimit tregtar: 33261252